

## PROCESVERBAL

### PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

**Rikualifikim i rruges Qazim Kariqi**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**45000000-7 - Punë ndërtimi**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 70,829,766.46** (shtatedhjetë milion ,teteqind e njezet e nente mije, e shtatedhjetë e gjashtë. dyzet e gjashtë) **leke pa tvsh**

**Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj:** 3 (tre) muaj

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kavajë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe nenit \_\_\_\_\_

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

#### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të viteve 2023, 2024 dhe 2025, lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht,plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2 gërma ”b”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Bazuar në nenin 43 pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kjo kërkesë

konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Kërkesa për paraqitjen e xhiros së viteve financiare 2023, 2024 dhe 2025, nuk i kufizon operatorët ekonomik vetëm në vite që mund të jenë jo të sukseshme financiarisht, por me kohështrirje tre vjecare. Vlera e xhiros së kërkuar në masë jo më e vogël se vlera e fondit limit shkon përshat me vlerën e fondit limit dhe afatin e realizimit të kontratës. Konkretisht niveli i aktivitetit të shoqërisë është në masë financiare ekuivalent me vlerën e mundshme të kontratës objekt prokurimi.

**2.2.2** Kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2023, 2024 dhe 2025 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nëneni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, në nenin 43 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe nenin 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar"

**2.2.3.** Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 dhe për vitin 2026, ku të perfshihet kasti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" nëneni 26 pika 6, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues i përcaktuar mësipër përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Referuar nenin 26 pika 7, kanë për detyrë të japin sqarime dhe dokumente mbështetëse mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar, në çdo rast, me kërkesë të Autoritetit Kontraktor.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogarit të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të provuar këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- i. Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin publik të paraqitet:
  1. formularin/formularët e vleresimit, të shoqëruar me aktin/aktet e kolaudimit dhe situacionet përkatëse, sipas shtojcës nr.9;
  2. faturat tatimore perkatëse të deklaruara në organet tatimore;
  3. kontratën/kontratat e zbatimit të punime të ndërtimit;
  4. çertifikatën/çertifikatat e marrjes në dorezim ose çertifikatën/çertifikatat e përkohshme të marrjes në dorëzim.

Në rast se kontratat e ngjashme janë lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqiten edhe kontratat e bashkëpunimit midis tyre.

Në rast se kontrata/kontratat e ngjashme janë lidhur në cilësinë e nënkontraktorit, operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin gjithashtu kontratën/kontratat bazë të lidhur me Autoritetin Kontraktor, në të cilën të jenë përfshirë dhe detyrimet e marra përsipër për t'u realizuar nga nënkontraktori.

- ii. Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin privat të paraqitet:
  1. kontrata/kontratat e sipërmarrjes së zbatimit të punime të ndërtimit;
  2. situacionet;
  3. faturat tatimore perkatëse të deklaruara në organet tatimore;
  4. akti/aktet e kolaudimit;
  5. çertifikatën/çertifikatat e marrjes në dorezim ose çertifikatën/çertifikatat e përkohshme të marrjes në dorëzim.

Në rast se kontratat e ngjashme janë lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqiten edhe kontratat e bashkëpunimit midis tyre.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve “a” ose “b” e bën ofertën të kualifikueshme

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet referuar nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.2. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorive dhe niveleve, si më poshtë:

1. NP 1 – A Punime gërmimi në tokë
2. NP 4 – B Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
3. NP 7 – B Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.
4. NP 11 – A Ndertime për nenstacionet, kabinat e transformatoreve, linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjise elektrike

5. NP 12 – A Punime të inxhinierisë mjedisore
6. NS 1 – A Punime për prishjen e ndërtimeve.
7. NS 6 – A Sinjalistika rrugore jondricuese.
8. NS 18 – A Punime topogjeodezike.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

*Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

*NP 1 - Punime gjërmimi në tokë.* Ne kete projekt trajtohen germimet ne trupin e rruges dhe kanaleet anesore, ndertimi i mbushjes dhe germimi per strukturat e Themeleve. Germimet dhe mbushjet e nevojshme per krijimin e trupit te rruges, kanaleve kulluese anesore, akseset, kalimet dhe pjerresite dhe te tjera si keto, si edhe per ndertimin e strukturave, duhet te behen ne format dhe dimensionet e treguara ne vizatimet perkatese, vetem ne rastet e ndryshimeve te mundshme qe Punedhensesi do te adoptoje, dhe te gjitha kostot qe sjellin keto lloj punimesh do te jene ne ngarkim te Kontraktorit, duke perfshire edhe ato per punimet mbrojtese apo te perforcimeve te mundshme, te gjitha keto duhet te jene llogaritur nga ai ne vendosjen e çmimit per njesi. Pjerresite e germimeve dhe dhe mbushje duhet te kryhen sipas pjerresise se pershtatshme sipas natyres dhe karakteristikave fiziko-mekanike te formacioneve

Konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara meçfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.

Konkretisht:

- Germim dheu me ekskavator zinxhir 0.5m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi >2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet
- Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi >2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet
- Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi >2 m,prani uji, kategoria III, me shk ne toke
- Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1m , h=1.5m, toke zak,
- Germim dheu me ekskavator goma 0.15m<sup>3</sup>, ne themele,toke e zakonshme, kategoria III, me shk ne toke
- Mbushje, rafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30m, toke e zakonshme,

- Germim dheu me ekskavator zinxhir 0.5m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi >2 m, toke zak, kategoria IV, me shk. ne mjet
- Germim dheu me ekskavator goma 0.35 m<sup>3</sup>, 0.40m<sup>3</sup> ne themele, toke e zakonshme, kategoria III, me shk ne toke
- Germim dheu me ekskavator zinxhir 0.5m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi >2 m,ne prani uji, kategoria IV, me shk. ne mjet
- Transport dheu me auto deri 5.0 km >

*Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogel se 20 milion leke.*

*NP 4 - Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore*

**Konkretisht:**

- Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri
- Shtrese stabilizant t=10cm
- Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges perhapur e ngjeshur me makineri
- Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri
- Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice 4cm, me makineri
- Shtrese binderi me zall lavatrice , 5 cm , me makineri
- Shtrese asfaltobetoni me granil me gur kave, 4 cm me makineri
- Shtrese zhavori
- Shtrese rere
- Struktura te holla monolite betoni C 20/25
- Struktura monolite betoni C 20/25
- Struktura monolite betoni C 12/15

*Niveli i klasifikimit është B. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e madhe se 21 milion lekë dhe me e voges se 50 milion lekë.*

*NP 7 - Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.*

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pishëm, ujësjellsat, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës*

deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

Konkretisht:

- Mbingritje  $h=0.5\text{m}$ , Pusete ekzistuese UZ  $\varnothing 1.0\text{m}$
- Tombino me tuba betoni  $\varnothing 1000$ , mbi shtrese betoni
- Tombino me tuba betoni  $\varnothing 1200$  mbi shtrese betoni
- Tombino me tuba betoni  $\varnothing 1500$  mbi shtrese betoni
- Ndertim puseta betoni  $1.5 \times 1.5$ ,  $H=2\text{m}$  + kapak gize
- Ndertim puseta betoni  $H=3.5\text{m}$ ,  $D = 1.5\text{m}$  + kapak gize
- Ndertim puseta kryesore betoni  $2 \times 2$  m, kapak gize  $H=2.5-3.5\text{m}$
- Ndertim pusete kontrolli elektroteknike, me kapake gize,  $1,0 \times 1.0 \times 1.0$  m
- F.V Tuba metalike  $D=140\text{mm}$
- F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8  $d=315$  mm
- Pusete shiu  $40 \times 60$ ,  $h = 100$  cm, me kapak gize
- Puse kontrolli  $1 \times 1 \times 1,5\text{m}$

*Niveli i klasifikimit është B. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e madhe se 21 milion lekë dhe me e voges se 50 milion lekë.*

*NP 11 – Ndertime per nenstacionet, kabinat e transformatoreve, linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për shperndarjen e T/N dhe tensioni te mesem dhe per transformimin dhe shperndarjen e tensionit te ulet deri te perdoruesit e energjise elektrike , te kompletuar me punimet e muratures, plotesuese ose ndihmese, te vecanta ose te rrjetit.*

Perfshin ne menyre te thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shyllat metalike te nevojshme per transportin dhe shperndarjen e cfaredo lloj tensuioni, furnizimin dhe vendosjen ne veper te linjave elektrike per cfaredo numer fazash elektrike, ajrore ose tokesore.

Konkretisht:

- Cmontim, Spostim shtylla ekzistuese(perfshi linjen)
- F.V Tuba te brinjezuar HDPE SN8  $d=315\text{mm}$
- F.V Tuba te brinjezuar HDPE SN8  $d=400\text{mm}$
- F.V Shtylla metalike per ndricim,  $H=7\text{m}$ ,  $d=160\text{mm}$
- F.V Krah shtylla metalike KRH-MSI 1500/1500/10
- F.V Kuader komandimi komplet me santeri+ fotoelement
- F.V Elektroda tokezimi te xinguara  $50 \times 30\text{mm}$ ,  $L=150\text{cm}$
- F.V Tuba plastmasi  $\varnothing 80$
- F.V Automat magneto-termik 280V, 40A, 4P,  $I_d=0.03\text{A}$
- F.V Percjelles PV-500  $\varnothing 10\text{mm}^2$
- F.V Percjelles PV-500  $\varnothing 4\text{mm}^2$
- F.V Percjelles CU te izoluar me gome, per ndicim ne izolator, seksion  $16\text{mm}^2$
- Shirit sinjalizimi per kablllo 20 kv,

- Heqje+transport shylla metalike ekz, per ndricim rrugor
- F/V ndricues LED, fuqi 79W, 13063 lumen

*Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogel se 20 milion leke.*

*NP 12 - Punime të inxhinierisë mjedisore.* Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjessë ekulibrave hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

Punimet per ndertimin e objektit kane impakt mjedisor ne te gjithë zonen perreth saj, duke patur parasysh sasine e mbetjeve te gjeneruara nga punimet e prishjeve dhe germimeve. Bazuar ne ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" (i ndryshuar), si dhe nenit 39, pika 7, gërma "c", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" është e domosdoshtme që shoqëritë të jenë të pajisura me licencat, certifikatat dhe stafin e specializuar për implementimin e kërkesave të akteve ligjore gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit.

Konkretisht:

- Mbjellje bari ne skarpate
- F.V Mbjellje peme dekorative Bli 16-18 cm, ne trotuar, (cdo 6m)

*Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogel se 20 milion leke.*

*N.S –1 Punime për prishjen e ndërtimeve.* Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

Konkretisht:

- Prishje struktura prej betoni
- Prishje struktura prej guri
- Prishje mur, blloqe betoni
- Prishje mure betoni

*Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogel se 20 milion leke.*

*N.S –6 Sinjalistika rrugore jondricuese.* Konsiderohet vendosja ne veper , mirembajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondricuese, vertikale, horizontale dhe komplemetare .

Konkretisht:

- F.V Tabela tetekendore e vogel me A-B, 60-20
- F.V Tabela trekendore e vogel me A= 60
- F.V Tabela katrore normal me A= 60
- F.V Tabela rrethi detyrim normal, me D= 60
- F.V Tabela rrugore treguese 150x40 cm

- Vijezim shirita gjatesore dhe anesore me gjeresi 12 cm, termoplastike (sprajt)
- Vijezimet e kalimit te kembesoreve. Termoplastike (sprajt).

*Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogel se 20 milion leke.*

*NS 18 - Punime topogjeodezike.* Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Në këtë projekt përfshihen shumica e punimeve kerkojne ekspertizen profesionale te topografise. Nga fillimi i punimeve dhe deri ne perfundim topografia ka rendesi ne kete projekt, pasi ka sasi te konsiderueshme germimesh, rlevime, sheshime etj.

Topogjeodezia së bashku me Sistemet e Informacionit Gjeografik janë baza e planifikimit të territorit. Organizimi i shërbimeve përkatesë për studiot e planifikimit urban, standartizimi i plotë i tyre në përputhje me kërkesat e planifikimit, bën të mundur krijimin e të dhënave gjeohapësinore, klasifikimin dhe interpretimin e tyre të saktë si dhe sjelljen në ndërtimin e skenarëve planifikues.

*Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogel se 20 milion leke.*

2.3.3. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune, diplomë, certificate/dëshmi kualifikimi të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial /ekuivalente, librezë pune, CV për 1 (një) inxhinier ndërtimi, për 1 (një) inxhinier ndërtimi (Profili Transport/Infrastruktura), 1 (një) inxhinier hidroteknik, 1 (një) inxhinier elektrik, 1(një) inxhinier mjedisi dhe 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet/markshajder .Stafi i mësipërm, duhet te jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës **Shkurt - Prill 2026** si dhe te figurojë në licensën e shoqërisë.
2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial/ekuivalente dhe të vlefshme për 1(një) teknik ndërtimi, 1 (nje) teknik topograf, 2 (dy) hidraulikë, 2 (dy) elektriciste, 2 (dy) karpentier, 3 (tre) specialiste per rruget dhe asfaltet, 2 (dy) specialiste per vendosjen e bordurave te betonit, 2(dy) pllakashtrues per trotuaret dhe 1(nje) saldator .

Stafi i mësipërm, duhet te jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik të paktën gjatë periudhës **Shkurt - Prill 2026**.

5. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe leje drejtimi përkatëse për 5 (pese) eskavatoristë, 4 (kater) buldozeristë, 5 (pese) automakinistë dhe 7(shtate) shoferë.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” neni 26 pika 6, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues i përcaktuar mesipër përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Referuar neni 26 pika 7, kanë për detyrë të japin sqarime dhe dokumente mbështetëse mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar, në cdo rast, me kërkesë të Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 39 pika 6 c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e punimeve. . Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht gjithashtu edhe me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.2 të kriterëve teknike. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

- Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projektin konstruktiv. Gjithashtu kërkesa për inxhinier ndërtimi është në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP 4, NS 1.
- Inxhinieri i Ndërtimit profili infrastrukture/transport rrugor është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projektin konstruktiv. Gjithashtu kërkesa për inxhinier ndërtimi profili transport/infrasktrukture rrugore është në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP 4, NS 1.
- Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv. Gjithashtu kërkesa për inxhinier hidroteknik është në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP 7.
- Inxhinier Mjedisi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve në lidhje me mjedisin te objektit lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv. Gjithashtu kërkesa për inxhinier mjedisi është në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP 12.
- Inxhinier Topograf/ Gjeodet/Markshajder është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve qe perfshin kuota dhe piketime lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv. Në këtë projekt përfshihen shumica e punimeve kerkojne ekspertizen profesionale te topografise. Nga fillimi i punimeve dhe deri ne perfundim topografia ka rendesi ne kete projekt, pasi ka sasi te

konsiderueshme germimesh, rilevime, sheshime etj. Gjithashtu kërkesa për inxhinier mjedisi është në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NS 18.

- Inxhinieri Elektrik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike /elektronike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt preventiv . Gjithashtu kërkesa për inxhinier elektrike është në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP11 .

Percaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" dhe në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për 1 (një) ekspert që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve dhe 1 (një) ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.“.

Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Eksperti që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve duhet të jete në kantier për minimimin e aksidenteve në punë.

Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave duhet të jete në kantier në rast aksidentesh në punë, për të dhënë ndihmë e parë.

Operatorët ekonomikë duhet të kenë në stafin e tyre specialistët e nevojshëm për realizimin e kontratës 1 (një) teknik ndërtimi, 1 (një) teknik topograf, 2 (dy) hidraulikë, 2 (dy) elektriciste, 2 (një) karpentier, 3 (tre) specialist për rruget dhe asfaltet, 2 (dy) specialiste për vendosjen e bordurave të betonit, 2 (dy) pllakashtrues dhe 1 (një) saldator.

Ky staf është i nevojshëm për zbatimin e punimeve të ndërtimit, piketimit, saldimit, punimeve të betonit dhe punimeve hidraulike, elektrike dhe shtrimit të trotuareve.

Operatorët ekonomikë duhet të kenë në stafin e tyre manovratorët e nevojshëm për drejtimin e mjeteve të nevojshme për realizimin e kontratës. Referuar mjeteve të parashikuara në pikën 2.3.5 të kriterëve të vecanta të kualifikimit dhe Urdhrit nr.200 datë 16.05.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit" neni 8 është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë në stafin e tyre manovratorët me dëshmi drejtimi si eskavatoristë (për drejtimin e mjeteve si eskavator gërmimi e ngarkimi dherash të të gjitha llojeve, fadromë e të gjitha llojeve, qofshin këto me goma dhe me zinxhirë), buldozeristë (për drejtimin e mjeteve si buldozer gërmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke, të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperët, grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e

peshave, shpimin e puseve etj.), automakinistë (për drejtimin e automjeteve për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti: -autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak) dhe shoferë (për drejtimin e automjeteve të llojit kamion apo kamioncinë të tonazheve të ndryshme).

**2.3.4.** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 91(nentedhete e nje) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, shoferë, manovratorë, stafi teknik) për periudhën **Shkurt – Prill 2026**, i lëshuar nga Administrata Tatimore.
- Listëpagesat për periudhën **Shkurt -Prill 2026**, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim", sic përcaktohet në tabelen bashkelidhur.

<b>PERLLOGARITJA E PUNETORISE</b>						
<b>Objekt</b>		<b>Rikualifikim i rruges Qazim Kariqi</b>				
<b>NR.</b>	<b>KODI</b>	<b>EMËRTIMI I PUNIMEVE.</b>	<b>NJËSI A</b>	<b>SASIA</b>	<b>ORE PUNE/ NJESI</b>	<b>ORE PUNE TOTAL</b>
		<b>1. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME</b>				
1	3.405/1	Prishje struktura prej betoni	m3	450	1.75	787.5
2	3.405	Prishje struktura prej guri	m3	150	1	150
3	3.581	Mbingritje h=0.5 m, Pusete ekzistuese UZ Φ 1.0 m	copë	6	1.18	7.08
4	3.367	Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni	m	200	8.2	1640
5	3.368	Tombino me tuba betoni Ø 1200, mbi shtrese betoni	m	250	11	2750
6	3.369	Tombino me tuba betoni Ø 1500, mbi shtrese betoni	m	315	15.9	5008.5
7	3.642	Ndërtim puseta betoni 1.5x1.5 H=2 m+kapak gize	copë	18	60	1080
8	3.393/1	Ndërtim puseta betoni H=3.5m, D=1.5m + kapak gize	copë	2	10.5	21
9	3.717	Ndërtim Pusete kryesore betoni 2x2 m kapak gize H=2.5-3.5 m	copë	2	26	52

10	3.588	Ndertim Pusete kontrolli Elektrotelefonike, me kapak gize, 1.0x1.0x1.0 m	copë	2	7.2	14.4
11	3.407	F.V. Tuba metalik D=140mm	ml	36	0.35	12.6
<b>2. LINJA T/L GERMIMI I GROPAVE TE SHTYLLAVE</b>						
12	3.557	Çmotim, Spostim shtylla ekzistuese (perfshi linjen)	ml	2	6	12
<b>3. PUNIME GERMIMI</b>						
13	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	3888.5		
14	3.104/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet	m3	56		
15	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	756		
16	3.88/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne toke	m3	368.56		
17	3.25/b	Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak.	m3	239	3.6	860.4
18	3.137	Germim dheu me ekskavator goma 0.15 m <sup>3</sup> , ne themele, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke	m3	47.8		0
19	3.47/1b	Mbushje, rafshim,ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te zakonshme	m3	20	0.84	16.8
20	3.104/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet	m3	612		0
21	3.139	Germim dheu me ekskavator goma 0.35~0.40m <sup>3</sup> , ne themele, toke zak, kat III, me shkarkim ne toke	m3	1057		0
22	3.103/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji ~ 2m kategoria IV, me shk ne toke	m3	138.5		0
<b>4. PUNIME SHITESASH</b>						
23	3.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	69.8	0.34	23.732
24	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	150	0.075	11.25
25	3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	634.05	0.34	215.577
26	3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	5876	0.01	58.76
<b>5. ANALIZA TEKNIKE</b>						
27	3.233/1	Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice,4cm,me mak	m2	150	0.095	14.25

28	3.229/1	Shtrese binderi me zall lavatrice,5cm,me makineri	m2	150	0.109	16.35
29	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	5876	0.095	558.22
<b>6. PRISHJE</b>						
30	2.426/2	Prishje mur blloqe betoni	m3	20	3.3	66
31	2.426/5	Prishje mure betoni	m3	15	16.3	244.5
<b>7. PUNIME MURATURE GURI</b>						
32	2.88	Mur me blloqe betoni 20cm, deri - 3m, me LL.P. M-15	m3	10	10	100
<b>8. NENSHTRESA DHE SHITESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE</b>						
33	2.258/2	Shtrese zhavori	m3	153	1.2	183.6
34	2.258/2	Shtrese zhavori	m3	535.5	1.2	642.6
<b>9. PUNIME SHITESASH 2</b>						
35	2.261	Shtrese rere	m3	261.28	2.175	568.284
<b>10. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA</b>						
36	3.164/1t	F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm	ml	1530	1.5	2295
37	3.164/2t	F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm	ml	70	1.78	124.6
38	3.169	F.V. Shtylla metalike per ndricim, H=7m, d=160mm	copë	62	1.8	111.6
39	3.168	F.V. Krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10	copë	62	1.2	74.4
40	3.172	F.V. Kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement	copë	2	6	12
41	3.182	F.V. Elektroda tokezimi te xinguarra 50x3mm L=150cm	copë	62	0.4	24.8
42	3.176	F.V. Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086	copë	62	1.9	117.8
43	3.933	F.V. Tabela tetekendore e vogel me A-B, 60-20	copë	14	0.5	7
44	3.936	F.V. Tabela trekendore e vogel me A = 60	copë	11	0.5	5.5
45	3.921/1	F.V. Tabele katrore normal me A=60	copë	12	0.5	6
46	3.934/1	F.V. Tabele rrethi "detyrim" normal me D = 60	copë	8	0.5	4
<b>11. UJESJELLES E KANALIZIM I JASHEM</b>						
47	2.342	Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize	copë	40	5.6	224
48	2.575	Puse kontrolli 1x1x1.5m	copë	12	50.3	603.6
<b>12. PUNIME BETONI E BETONARMEJE</b>						
49	3.244/1	Struktura te holla monolite betoni C 20/25	m3	109.7	12.8	1404.16
50	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	65.21	12.8	834.688
51	3.240	Struktura monolite betoni C 12/15	m3	35.1	13	456.3

52	3.244/1	Struktura te holla monolite betoni C 20/25	m3	15	12.8	192
<b>13. PUNIME TE NDRYSHME</b>						0
53	3.616/b	F.V. Bordura betoni 15x30cm	m	1755	1	1755
54	3.620	Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka	m2	4227	2.14	9045.78
55	3.654/1	F.V. Tuba plastmasi ø 80	m	1530	0.25	382.5
56	3.643	Mbjellje bari ne skarpat	m2	350	0.17	59.5
<b>14. INSTALIME PER NDRICIM</b>						0
57	2.539	F.V. Automat magneto-termik 380V,40A, 4P,Id=0.03A	copë	2	1.2	2.4
58	2.481/5	F.V. Percjelles PV-500 Ø 10 mm2	ml	744	0.07	52.08
59	2.481/3	F.V. Percjelles PV-500 Ø 4 mm2	ml	372	0.04	14.88
<b>15. GAZ E NAFTESJELLES</b>						0
60	4.150/7	F.V. Percjellesa Cu te izoluar me gome, per ndricim, ne izolator, sexion 16mm2	km	0.3	210	63
<b>16. ANALIZA TEKNIKE PER PUNIMET DHE INSTALIMET TEKNOLOGJIKE</b>						0
61	4.141/a7.0	F.V. Shirit sinjalizimi per kablllo 20 kv	m	1390	0.04	55.6
<b>17. D. SINJALET DHE PAJISJET SHITESH. NGADALESUESIT E SHPEJTESISE</b>						0
62	3.966	F.V. Mbjellje peme dekorative Bli 16-18cm ne trotuar, (cdo 6m)	copë	64	1	64
63	3.953	F.V. Tabela rrugore treguese 150x40cm	copë	9	0.5	4.5
<b>18. B. SINJALET HORIZONTALE</b>						0
64	3.942/3	Vijezi shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm, Termoplastike (sprajt)	ml	2295	0.1	229.5
65	3.946/3	Vijeziimet e kalimit te kembesoreve. Termoplastike (sprajt)	m2	294	0.5	147
<b>19. ANALIZA JASHTE LISTE</b>						0
66	An	Heqje+Transport shtylla metalike ekz.per ndricim rrugor	copë	7	3	21
67	An	F.V ndricues LED,fuqia 79W,13063 lumen	copë	62	2	124
<b>Ore pune ne total per kryerjen e punimeve eferuar Normatives sipas Manualit te Ndertimit</b>						<b>33633.591</b>
<b>Dite pune 8 orareshe ne total</b>						<b>4204.198875</b>
<b>Peruidha per kryerjen e punimeve sipas grafikut eshte 3 muaj (22 dite pune/muaj * 3 muaj)</b>						<b>66</b>
<b>Numri i fuqise punetore per kryerjen e punimeve (dite pune total / 22)</b>						<b>63.699982</b>
<b>Numri total i fuqise punetore per kryerjen e punimeve</b>						<b>64</b>

Numri total 91 punonjes perfshin 64 punetore perlloritur si me siper, 6 stafi teknik dhe 21 manovratore e shofere.

**2.3.5.** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet dhe pajisjet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë: 3 (tre) kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës  $\geq 20$  ton; 4 (kater) kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 20 ton; 2 (dy) kamionë/kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton, 1 (një) makineri skarifikimi, 1 (nje) autobot uji, 2 (dy) rul kompresor me vibrim gome-cilindër deri 6 ton, 1 (nje) eskavator me goma 0.25m<sup>3</sup>, 1 (nje) eskavator me goma 2m<sup>3</sup>, 1 (nje) eskavator me goma 4m<sup>3</sup>, 1 (nje) eskavator me zinxhire 0.5 m<sup>3</sup>, 1 (nje) tronkete per hapjen e kanaleve KUZ dhe KUB, 1 (nje) grejder, 1 (nje) autobitumatrice, 1 (nje) asfaltoshtruese, 1 (nje) minifadromë, 1 (një) autobetoniere, 2 (dy) vibrator thellësie, 1 (nje) autopompe, 1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë, 1 (nje) autovinc me kapacitet 5 Ton, 1 (nje) tokmak elektrik, 3( tre) matrapike, 1 (nje) aparat topogjeodezikme GPS, 1 (nje) sprucator boje per vijezim, 1( nje) saldatrice elektrike, 1 (nje) aparat detektues per testimin e shtresave rrugore, 1(nje) aparat per detektimin e linjave elektrike.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë leje e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat), foto përkatëse ballore dhe anësore.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike që merren me qira, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë kontratë noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirase duhet të jenë leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat), foto perkatëse ballore dhe anësore..

Për mjetet dhe pajisjet që nuk pajisen me leje qarkullimi operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë dokument te vlefshëm që vërteton pronësinë apo marrjen me qira të tij dhe foto perkatëse.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit public" neni 26 pika 6, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues i përcaktuar mesipër përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Referuar nenit 26 pika 7, kanë për detyrë të japin sqarime dhe dokumente mbështetëse mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar, në cdo rast, me kërkesë të Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".

Konkretisht:

-3(tre) kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës  $\geq 20$  ton; 4 (kater) kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 20 ton; 2 (dy) kamionë/kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton;., parashikuar ne zerat e punimeve ne preventin, konkretisht Transport dheu me auto deri 5.0 km, Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri, Shtrese stabilizant t=10cm, Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me

makineri, Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice,4cm,me mak, Shtrese binderi me zall lavatrice,5cm,me makineri, Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri, Prishje mur blloqe betoni, Prishje mure betoni, Mur me blloqe betoni 20cm, deri - 3m, me LL.P. M-15, Shtrese zhavori, Shtrese rere, F.V. Tabela tetekendore e vogel me A-B, 60-20, Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize, Puse kontrolli 1x1x1.5m, F.V. Bordura betoni 15x30cm

-1 (një) makineri skarifikimi, parashikuar ne zerat e punimeve ne preventin, konkretisht Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri

-1 (nje) autobot uji, parashikuar ne zerat e punimeve ne preventin, konkretisht Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri , Shtrese stabilizant t=10cm , Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri

-2 (nje) rul kompresor me vibrim gome-cilindër deri 6 ton,parashikuar ne zerat e punimeve ne preventiv, konkretisht Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri, Shtrese stabilizant t=10cm, Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri, Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice,4cm,me mak, Shtrese binderi me zall lavatrice,5cm,me makineri, Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri

-1 (nje) eskavator me goma 0.25m<sup>3</sup>,1 (nje) eskavator me goma 2m<sup>3</sup>, 1 (nje) eskavator me goma 4m<sup>3</sup>, 1 (nje) eskavator me zinxhir 0.5m<sup>3</sup>, parashikuar ne zerat e punimeve ne preventiv, konkretisht Prishje struktura prej betoni, Prishje struktura prej guri , Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri, Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri, Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet,Germim dheu me ekskavator goma 0.35~0.40m<sup>3</sup>, ne themele, toke zak, kat III, me shkarkim ne toke, Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji ~ 2m kategoria IV, me shk ne toke, Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne toke

-1 (nje) tronkete per hapjen e kanaleve KUZ dhe KUB, parshikuar ne zerat e punimeve ne preventiv F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm, F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm ,

-1 (nje) grejder, parshikuar ne zerat e punimeve ne preventiv Shtrese stabilizant t=10cm

-1 (nje) autobitumatrice, parshikuar ne zerat e punimeve ne preventiv Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice,4cm,me mak, Shtrese binderi me zall lavatrice,5cm,me makineri, Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri,

-1 (nje) asfaltoshtruese, parshikuar ne zerat e punimeve ne preventiv Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice,4cm,me mak, Shtrese binderi me zall lavatrice,5cm,me makineri, Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri,

-1 (nje) minifadromë,parshikuar ne zerat e punimeve ne preventiv Germim dheu me ekskavator goma 0.15 m<sup>3</sup>, ne themele, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke

-1 (një) autobetoniere, parshikuar ne zerat e punimeve ne preventiv Struktura te holla monolite betoni C 20/25,Struktura monolite betoni C 20/25, Struktura monolite betoni C 12/15 ,

-2 (dy) vibrator thellësie, parshikuar ne zerat e punimeve ne preventiv konkretisht Ndertim puseta betoni 1.5x1.5 H=2 m+kapak gize , Ndertim puseta betoni H=3.5m, D=1.5m + kapak gize , Ndertim Pusete kryesore betoni 2x2 m kapak gize H=2.5-3.5 m, Ndertim Pusete kontrolli Elektrotefonike, me kapak gize, 1.0x1.0x1.0 m , Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize, Struktura te holla monolite betoni C 20/25, Struktura monolite betoni C 20/25 , Struktura monolite betoni C 12/15,

-1 (nje) autopompe,

-1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë,

-1 (nje) autovinc me kapacitet 5 Ton, parshikuar ne zerat e punimeve ne preventiv konkretisht, Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni , Tombino me tuba betoni Ø 1200,

mbi shtrese betoni , Tombino me tuba betoni Ø 1500, mbi shtrese betoni, F.V. Tuba metalik D=140mm, F.V. Krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10

-1 (nje) tokmak elektrik, parshikuar ne zerat e punimeve ne preventiv konkretisht, Mbushje, rafshim,ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te zakonshme

-3( tre) matrapike, parshikuar ne zerat e punimeve ne preventiv konkretisht Prishje struktura prej betoni, Prishje struktura prej guri

-1 (nje) aparat topogjeodezik me GPS, kerkohet ne perputhje me kategorine e licenses NS18,

-1 (nje) sprucator boje per vijezim, parshikuar ne zerat e punimeve ne preventiv konkretisht Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm, Termoplastike ( sprajt), Vijezimet e kalimit te kembesoreve. Termoplastike (sprajt)

-1( nje) saldatrice elektrike parshikuar ne zerat e punimeve ne preventiv konkretisht F.V. Tuba metalik D=140mm.

-1(nje) aparat per testimin e shtresave rrugore per zerin e parashikuar ne preventiv konkretisht Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri

-1(nje) aparat per detektimin e linave elektrike nentokesore perpara punimeve te germimit, per te evituar demtimine e linjave elektrike.

2.3.6 Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1. Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalente.
2. Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2015** ”Sisteme të menaxhimit të mjedisit” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalente.
3. Certifikatën SSH/ EN/UNI **ISO 45001:2018/45001-2023** ”Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalent.
4. Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 50001-2018**, ”Sistemi i Menaxhimit të Energjisë” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalent.
5. Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 39001:2012** “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalent.
6. Certifikatën **ISO 3834-1:2024** “Kërkesat e cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike”,

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH/DIN/EN/UNI mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi

*kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis të projektit si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili specifikon kërkesat e përgjithshme për krijimin e një Sistemi të Menaxhimit të Energjisë në një organizatë dhe fokusohet në identifikimin e mundësive për përmirësimin e performancës së energjisë. ISO 50001 përcakton synimet dhe objektivat specifike për kursimin e energjisë, të cilat arrihen përmes programeve për menaxhimin e energjisë dhe monitorimin sistematik të variablave të energjisë.

ISO 39001:2012 “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor”.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

**ISO 3834-1:2024**, “Kërkesat e cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike”,

Standardi ISO 3834 (shpesh i referuar si EN ISO 3834) është një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat e cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike.

Ai është një standard teknik që fokusohet specifikisht në procesin e saldimit, duke siguruar që produktet e salduara të plotësojnë standartet e larta të cilësisë dhe sigurisë. Konkretisht është një standard teknik specifik që garanton që "procesi special" i saldimit është nën kontroll.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat e parashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.10 gërma “a”- “e”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.7. Operoret ekonomike duhet të jene të pajisur me leje mjedisore kodi III.2.B per grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në ligjin Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (Ndryshuar me ligjin nr. 32/2013, datë 14.2.2013; nr. 156/2013, datë 10.10.2013; nr. 28/2022, datë 17.3.2022).

2.3.8. Operatori Ekonomik duhet të kete Kontrate Shërbimi me nje laborator testimi të materialeve kryesore të ndërtimit (beton, asfaltobeton, materiale inerte), i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose nderkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-4:2019, SSH EN 12350-4:2019 dhe SSH EN 12504-4:2021 e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet të pakten nga njëri prej anëtarëve të grupit.

**Argumentimi:** Ne baze te nenit 77 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe piken 8 te nenit 40, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", me ane te ketij kriteri AK kerkon qe produktet te jene ne perputhje me standartet e duhura perpara se ato te perdoren, ky eshte detyrim ligjor kontraktor.

2.3.9. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë në pronësi ose me qira impiant/fabrikë asfalti e pajisur me leje mjedisore me kod III.1.B. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin edhe kontratë furnizimi me subjekte që kanë në pronësi ose me qira impiant/fabrikë asfaltii, të cilat duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore me kod II.1.B. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet të pakten nga njëri prej anëtarëve të grupit.

2.3.10. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë në pronësi ose me qira impiant/nyje inerte e pajisur me leje mjedisore me kod III.1.B. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin edhe kontratë furnizimi me subjekte që kanë në pronësi ose me qira impiant/nyje e fraksionimit të inerteve, të cilat duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore me kod II.1.B. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet të pakten nga njëri prej anëtarëve të grupit.

2.3.11. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë në pronësi ose me qira impiant/nyje prodhimi betoni e pajisur me leje mjedisore me kod III.1.B. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin edhe kontratë furnizimi me subjekte që kanë në pronësi ose me qira impiant/nyje e prodhimit te betonit, të cilat duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore me kod II.1.B. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet të pakten nga njëri prej anëtarëve të grupit.

**Argumentimi:** Kërkesat e pikave 2.3.9, 2.3.10 dhe 2.3.11 garantojnë Autoritetin Kontraktor me furnizimin në kohë dhe me cilësi të materialeve kryesore që nevojitet për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.12. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet garantojne furnizimin e me materialet kryesore per realizimin e objektit te prokurimit konkretisht:

-Kontrate furnizimi paraprake te vlefshme me prodhuesin ose distributorin e autorizuar per kete procedure prokurimi per zerin Tombino te dimensioneve Ø 1000, 1200, 1500 mm sipas perlloritjes se zerave te preventivit. Ne rast paraqitjeje te kontrates me distributorin e autorizuar duhet te paraqese dokument qe verteton lidhjen me prodhuesin.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet të paktën nga njëri prej anëtarëve të grupit.

**Argumentimi:** Kërkesa e pikes 2.3.12 garantojnë Autoritetin Kontraktor me furnizimin në kohë te materialeve specifike, te madhesive te konsiderueshme te parapergatitura te tipit Tombinove me dimensione te medha , konkretisht Ø 1000, 1200, 1500 mm, te parashikuara ne zerat e preventivit, per perfundimin me sukses te kontrates.

**Operatorët ekonomikë, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021.**

**Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.**

**Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Janë sipas të dhënave dhe shënimeve teknike në projektet e zbatimit, relacionet, specifikimet etj. bashkëlidhur DST-ve, të hartuara nga projektuesi.